

Rregullat për Electrolux Family Club –Shqipëri

Filloni të aplikoni në 1 prill,2008.

Electrolux Family Club është një program në marrëdhënie me klientin duke shpërblyer besueshmërinë e klientëve të cilët blejnë produkte të Electrolux Group (AEG-Electrolux/Electrolux/Zanussi),ligjërisht i kontrolluar nga Electrolux CEE GmbH

Vetëm persona në moshë të rritur mund të behen anëtarë të Electrolux Family Club.Anëtarët e klubit nuk mund të jenë persona legal as persona të tjerë që blejne produkte të Electrolux per qëllime profesionale.

Avantazhet për klientët që bëhen anëtar të Electrolux Family Club janë:

1.Ulje ne blerjet e mëtejshme të produkteve të Electrolux Group në dyqanet tona bashkëpunëtore:

Anëtarët kanë mundësi për të mbledhur pikë dhe realizuar kupona me zbritje speciale me blerjen e ndonjë produkti të Electrolux Group.Kjo zbritje do të sigurohet nga kompania Global Servis dhe mund të realizohet vetëm në dyqanet e Global Servis.

Globe Center

Adresa: Rr. "Kavajës", ish-parku Autobuzave
Tiranë, Albania.

tel: +355 4 22 61 450

fax: +355 4 22 70 448

cel: +355 69 20 78 600

e-mail: info@globe-stores.net

web: www.electrolux.com.al

Electrolux

Adresa: Pranë Kinema Millenium, Elbasan

Tel/Fax +355 54 44456

Cel: +355 69 20 54 380

Electrolux

Adresa: Lagja "Liri", Rruga:"Jakov Xoxa"

pranë Urës së Sheqit, Fier

Tel/Fax:+355 03 429 392

Cel: + 355 69 20 61 614

Electrolux

Adresa: Bulevard "Fan S. Noli", Korçë

Tel / Fax: 082 46820

Cel: + 355 69 20 68 068

Electrolux

Adresa: Lagjja "18 Shtatori", Gjirokastrë

Tel / Fax: 084 68 562

Cel: + 355 69 20 54 381

2.Ofertat e bashkëpunëtorëve të shërbimeve në shtëpi

Anëtarët kanë mundësinë të blejnë shërbime dhe produkte me cmime të ulta.Këto Shërbime dhe produkte do të sigurohen nga Partnerët e jashtëm të Electrolux Family Club dhe ndaj kushteve të tyre individuale.Electrolux Family Club nuk është përgjegjëse për produktet dhe shërbimet e siguruar nga Partnerët e saj të jashtëm.

Kushtet dhe rregullat për pjesëmarrjen në programin e Electrolux Family Club.

ANËTARËSIMI

1.E drejta për tu anëtarësuar në programin e Electrolux Family Club (më poshtë e referuar si EFC) është përfituar gjatë blerjes së ndonjë produkti të Electrolux Group(AEG-Electrolux/Electrolux/Zanussi),mbi shumën minimale prej 50.000 lek,me kusht që blerësi të mbushi formularin e aplikimit të EFC dhe pajisur me një kopje të faturës dhe një kopje të fletës së garancisë ,si provë e blerjes, ta dorëzojë atë në adresën:Electrolux Family Club,Rr Kavajës,ish parku i autobusave,Tiranë.

2.EFC është e detyruar të dërgojë një kartë anëtarësimi të EFC,si vërtetësi e anëtarësimit ,ndaj çdo blerësi nga i cili ai ka marrë një formular aplikimi.

3. Anëtari i EFC është i detyruar të informojë EFC në kohën e duhur rreth ndërrimit të numrit të telefonit ose të dhëne tjetër.

4.Duke nënshkruar formën e pranimit në EFC ,blerësi vërteton se ai ka pranuar kushtet dhe rregullat për anëtarësimin në programin e EFC.

EFC është e autorizuar të përdori të dhënat e anëtarëve,të ruajtura në bazën e të dhënave,për qëllime promovionale dhe mund të transferojë të dhëna rreth anëtarit jashtë Shqipërisë drejt një shteti i cili është pjesë e Bashkimit Evropian për qëllimet e EFC.

5.EFC nuk është e përgjegjshme për humbjen ,vonesën ose të dhënat e gabuara të anëtarësimit që është numri i telefonit.

6.Nëse karta e anëtarësimit do të humbi ose do ta vjedhin ,anëtari do të jetë i detyruar të informojë EFC e cila do ti nxjerri një kartë tjetër.

7. Anëtari mund ta përfundojë anëtarësimin e tij duke informuar EFC për të në shkrim dhe duke kthyer kartën e tij. Pas mbarimit të anëtarësitimit, pikët e padeklaruar janë fshirë, dhe kuponat e nxjerra janë të pavlefshëm.

8. Duke nënshkruar formën e pranimit, ju bëheni një pjestar i klubit dhe ju garantoni se pranoni plotësisht kushtet dhe rregullat për pjesëmarrjen në programet e Electrolux Family Club, që ju jeni të njohur me përbërësit e tyre dhe ju jeni dakort se Electrolux Family Club mban të drejtat për të ndryshuar kushtet dhe rregullat e mësipërme në çdo kohë në pjesë /ose të plotë ndërsa mban të drejtat për të mbyllur në çdo kohë të gjithë programin e Electrolux Family Club dhe të drejtën për të anuluar në çdo kohë çmimet, duke përfshirë çmimet për pikët e fituara, e njëanshme dhe pa arsye të veçantë, ose detyrim nga ana e Electrolux për të shpjeguar qëndrimin/vendimin e tij. Pas nënshkrimit të formës së pranimit, ju keni pranuar kushtet e mësipërme të plota dhe pa rezerva ose vonesa.

9. EFC mban të drejtën për të ndryshuar, rregulluar dhe për të kontrolluar pikët dhe strukturën e fitimit të çmimit. Të gjitha ndryshimet e mundshme duhet të raportohen drejt anëtarëve në kohën e duhur me shkrim.

10. Këmbimi i të gjitha materialeve të nevojshme midis anëtarëve dhe klubit realizohen veçanërisht duke telefonuar EFC ose duke vizituar dyqanet e partnereve të EFC.

11. Cdo anëtar i EC duhet të informojë menjëherë klubin për ndonjë ndryshim të dhëne personale të caktuar në formulimin e anëtarësitimit.

12. Anëtarët në EC mund të kenë pretendime vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1. Ulje në blerjet e mëtejshme të produkteve të Electrolux Group në dyqanet tona bashkëpunëtoare:

1. Pas çdo blerje anëtari i EFC është i detyruar (nëse dëshiron të marrë pjesë në mbledhjen e pikëve) të dorëzojë një kopje të faturës dhe një kopje të plotësuar dhe të certifikuar të kartës së garancisë, emër dhe mbiemër dhe numrin e kartës së anëtarësitimit në adresën e EFC.

2. Çdo anëtar i EFC do të fitojë një pikë për çdo lek të harxhuar për blerjen e një produkti të Electrolux Group (1 lek = 1 pikë, pikët janë grumbulluar për numra të plotë). Pikët janë të vlefshme për 2 vjet, nëse nuk përdoren brenda 2 vjetësh, pikët do të fshihen nga llogaria e klientit.

3. Synimi për mbledhjen e pikëve është realizimi i të drejtës për një kupon.

E drejta për një kupon realizohet pas mbledhjes së 50.000 pikëve.
Vlerat e kuponëve janë llogaritur sipas tabelës,dhe ato varen nga numri i pikëve të mbledhura,për çdo faturë të veçantë.

Niveli	Pikët	Vlera e kuponit
1	Nga 50.000 deri në 99.999	3% të vlerës
2	Nga 100.000 deri në 249.999	4% të vlerës
3	Mbi 250.000	5% të vlerës

Shpjegim:Kur blerësi mbledh,për shembull 60.000 pikë për një faturë (do të thotë 60.000 lek),ai do të marrë teEFC,sipas kërkesës, një kupon në vlerën 1800 lek(3% e 60.000 lek =1800 lek)

4.EFC është e detyruar të freskojë dhe të informojë blerësin me shkrim mbi numrin e pikëve të grumbulluara për çdo faturë të caktuar.

5.Nese anëtari dëshiron të realizojë gift coupon,EFC është e detyruar ta njoftojë me telefon në mënyrë që të marrë kuponin Dhuratë në Qendrën e EFC.

6. Kuponi Dhuratë nuk mund të kthehet në lekë.Ai duhet të realizohet vetëm një herë dhe vetëm për blerjen e produkteve Electrolux Group brenda periudhës prej 6 muajsh nga dita që është nxjerrë karta e anëtarësimit në EFC.Nese kuponi Dhuratë nuk është realizuar brenda periudhës së caktuar në kupon,pikët mbeten të regjistruara në llogarinë e anëtarit, po të mos jenë të vjetra.

7. Kuponi Dhuratë duhet të paraqitet në realizimin e blerjes(kopje të kuponave nuk do të pranohen) bashkë me paraqitjen e kartës së anëtarësimit.

8. Kuponi Dhuratë mund të realizohet vetëm në pikat e shitjeve të shënuara me afishet e Electrolux Family Shop.

9.Nese kuponi Dhuratë është realizuar brenda periudhës së caktuar në kupon,mbledhja pasuese e pikëve fillon nga zero.Nese vlera e produktit të blerë me kuponin Dhuratë është më e lartë se vlera e kuponit Dhuratë vetë ,atëherë shuma e pagesës shtesë do të regjistrohet në llogarinë e anëtarit në bazën e të dhënave qendrore të EFC,pajisur me një kopje të faturës dhe një kopje të kartës së garancisë.

10.Kuponat e zbritjeve nuk mund të transferohen drejt një personi tjetër,por e drejta për të përdorur zbritje në një blerje pasuese i qëndron vetem anëtarit të EFC.

11.Pikët e papërdorura bëhen të vjetra 2 vjet pas datës në faturë dhe fshihen pas asaj periudhe.

Ofertat e Partnerëve të shërbimeve në shtëpi

1. Anëtarët kanë mundësinë të blejnë shërbime dhe produkte me cmime të ulta. Këto shërbime dhe produkte do të sigurohen nga Partnerët e jashtëm të Electrolux Family Club dhe ndaj kushteve të tyre individuale. Electrolux Family Club nuk është përgjegjëse për produktet dhe shërbimet e siguruar nga Partnerët e saj të jashtëm.

2. EFC duhet të zgjedhi kompani të brendshme të cilat duhet të ofrojnë përgjate këtij programi shërbime dhe produkte me cmime të ulëta ekzkluzivisht për anëtarët e EFC.

3. EFC, si çdo person legal nga Electrolux, nuk pranon përgjegjësi për vlefshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të blera nga Partnerët e Shërbimeve në shtëpi të EFC.